



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

MIRATOHET

KRYETARI

Engjëllush BEKTESHI

RRËGULLORE

PËR

**KRITERET, PROCEDURAT, MËNYRËN E APLIKIMIT, VLERËSIMIN E KRITEREVE, KONTROLLIN E KUSHTEVE TË LIÇENSIMIT DHE FORMATET E LIÇENSAVE TË PRODHIMIT, ÇAKTIVIZIMIT, RIPARIMIT TË ARMËVE**

Nr. 66 datë 17.01.2017

Mbështetur në nenin 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të Ligjit nr. 74/2014, datë 10.07.2014 "Për Armët", të pikës 1, Kreu V, të Vendimit Nr. 658, Datë 29.7.2015 i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave për dhënien e licencave për prodhimin, çaktivizimin dhe riparimin e armëve", Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, nxjerr Rregulloren

NENI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përkufizime;

"Me armë zjarri kuptojmë armën e zjarrit në vetvete, municionet/dhe pjesët përbërëse të armës".

"Me prodhim, kuptohet procesi teknologjik i fabrikimit të armëve të zjarrit, municioneve dhe pjesët përbërëse nga lënda e parë në produkt të gatshëm si dhe

montimi i pjesëve të gatshme të importuara me qëllim bashkimin për krijimin e armëve të zjarrit municioneve dhe pjesët përbërëse”

“Me prodhim, kupohet edhe procesi për ri-modelimin, modernizimin e armës”

“Armë e zjarrit e çaktivizuar pjesërisht ose plotësisht” është arma e zjarrit e kategorive “A”, “B”, “C” e cila në mënyrë të pjesshme ose të plotë është bërë jofunksionale, përmes zbatimit të procedurës teknike në njërin nga pjesët kryesore të saj dhe që është certifikuar nga organi përgjegjës.

Çaktivizimi i armës së zjarrit është çaktivizimi i përkohshëm i cili nuk e prish funksionin e armës për përdorim ushtarak/civil, por vetëm e kufizon përkohësisht; çaktivizim i përhershëm është çaktivizimi me anë të të cilit i heqim armëve funksionin për përdorim ushtarak/civil, por nuk dëmtojnë pamjen dhe funksionalitetin e tyre (Përgatitja për muzetë etj.); çaktivizim përfundimtar, është çaktivizimin ku arma dhe të gjitha pjesët e saj përbërëse humbasin mundësinë për përdorim apo rikthim në përdorimin e tyre ushtarak/civil. (skrap, demontim).

## NENI 2

### Objekti i Rregullores

1. Rregullorja përcakton mënyrën e aplikimit, vlerësimin e kriterëve, dhe kontrollin e kushteve të liçensimit, si dhe formatet e liçensave.

## NENI 3

### Fusha e zbatimit, subjektet

2. Kjo rregullore zbatohet nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, dhe të gjithë personat fizikë ose juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të cilët janë objekt i kërkesave për liçensa për prodhimin, çaktivizimin, riparimin e armeve.

## NENI 4

### Llojet e liçensave

Llojet e liçensave janë:

- liçensë Prodhimi për **Armët, Pjesët përbërëse dhe Municionet e tyre**

- liçensë Çaktivizimi dhe/ose Riparimi për Armët, Pjesët përbërëse dhe Municionet e tyre

## NENI 5

### Afatet e vlefshmërisë së licencës

Afati i vlefshmërisë së licencës së prodhimit të armëve është 10-vjeçar, me të drejtë rinovimi,

Afati i vlefshmërisë së licencës për çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve është 7-vjeçar, me të drejtë rinovimi.

Procedura e rinovimit të licencës së prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve të zjarrit është e njëjtë me atë të dhënies së saj.

## NENI 6

### Mënyra e aplikimit të subjekteve

Personat fizikë ose juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të cilat duan të pajisen me liçensa për prodhimin, çaktivizimin, riparimin e armëve, paraqesin kërkesën me shkrim të shoqëruar me dokumentacionin e parashikuar në Vendimin nr. 658, datë 29.7.2015 i Këshillit të Ministrave, "për përcaktimin e procedurave për dhënien e licencave për prodhimin, çaktivizimin dhe riparimin e armëve", i cili dorëzohet pranë sekretarisë së AKSHE-së.

Dokumentet për licencë duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Në faqen e jashtme të zarfit që mban adresën e plotë të subjektit kërkues, nënshkrimin dhe vulën e tij, shkruhet adresa e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror i Eksporteve si dhe shënimi sipas rastit "dokumentaon për liçensë, prodhimi, çaktivizimi, riparimi armësh.

Kërkesa e protokolluar në protokollin e institucionit, pas nënshkrimit nga Kryetari i AKSHE-së i adresohet drejtorive të AKSHE-së, drejtorit të Legjislacionit dhe Përfaqësimit dhe Drejtorit të Analizës dhe Vlerësimit, për verifikim, shqyrtim, dhe dhënie mendimi mbi dokumentacionin e paraqitur.

Dosja e aplikimit për liçensë për prodhimin, çaktivizimin, riparimin e armeve, kalon për shqyrtim nga drejtorët, në sektorët përkatës brenda drejtorive, të cilët verifikojnë dokumentacion ligjor dhe teknik sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin Nr. 658, Datë 29.7.2015 i Këshillit të Ministrave, sipas kompetencave të mëposhtme:

## DREJTORIA E LEGJISLACIONIT DHE PËRFAQËSIMIT

### Sektor i Regjistrimit dhe i Liçensave:

Shqyrton dokumentacionin ligjor të paraqitur nga subjektet të cilët aplikojnë për t'u pajisur me liçensë për prodhimin, caktivizimin, riparimin e armeve, si dhe përgatit raportin përkatëse. Nëse dokumentacioni ligjor është i plotë, dosja kalon për shqyrtim në sektorët e tjerë. Në rast se konstatohen mangësi në dokumentacion dosja kalohet në sektorin e Legjislacionit dhe Përfaqësimit për të përgatitur shkresën për plotësim dokumentacioni.

Sektor i Regjistrimit dhe i Liçensave mban rregjistrin e aplikimit të subjekteve si dhe rregjistrin e liçensave të lëshuara për prodhim/caktivizim, riparim armësh.

### Sektor i Legjislacionit dhe i Përfaqësimit

Shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga subjektet të cilat aplikojnë për t'u pajisur me liçensë për prodhimin, caktivizimin, riparimin e armeve, si dhe përgatit raportet përkatëse.

Verifikon dokumentacionin ligjor të paraqitur në dosje dhe përgatit shkresat për plotësim dokumentacioni.

Përgatit të gjitha vendimet të cilat merren gjatë dhe pas procesit të licensimit për prodhimin, caktivizimin, riparimin e armeve.

## DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE ANALIZËS

### Sektor i Inspektimit:

Shqyrton dokumentacionin mbi mallin, identifikon dhe klasifikon mallrat objekt liçensimi si dhe përgatit raportet përkatëse.

Ndjek plotësimin e detyrimeve ligjore mbi raportimin e subjekteve të licensuara. Gjithashtu ky sektor hedh të dhënat e raportuara nga subjektet në rregjistrin e raportimeve dhe raportimeve sipas përcaktimeve të pikës 1, shkronja "dh", të Kreut II, të vendimit nr. 658, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave, gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së liçensës deri në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe i mban të dhënavat për të raportuar sipas detyrimeve që ka AKSH:

Zbardh liçensat të cilat miratohen nga Kryetari i AKSHE-së.

### Sektor i Vlerësimit dhe Analizës:

Shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga subjektet, në kuadër të verifikimeve mbi subjektet dhe palët e përfshira në transferim si dhe përgatit raportet përkatëse.

Mban kontakte me autoritetet homologe komunikon me institucionet e inteligjencës dhe ato me të cilat AKSHE bashkëpunon për mbledhjen e informacionit dhe analizën e riskut.

Mbledh dhe analizon informacionin në rrugë zyrtare dhe nëpërmjet faqeve të internetit të hapura ose të kufizuara mbi palët e përfshira në procesin e licensimit si dhe veprimtarinë e tyre.

### **Hartimi i raporteve përfundimtare**

Në përfundim të procesit të verifikimit, dhe shqyrtimit të dosjes së aplikimit, drejtorët e drejtorive përgatitin një raport përmbledhës për konstatimet në aplikim.

Ky raport i kalohet Kryetarit të AKSHE-së, i cili merr vendimin përfundimtar për miratimin apo refuzimin e licensës së prodhimit, caktivizimit, riparimit të armëve.

## **NENI 7**

### **Dokumentet për licensë Prodhimi/caktivizimi/riparimi armesh.**

Subjekti që kërkon të pajiset me licensë për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve për kategoritë "A", "B" dhe "C" paraqet pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve kërkesën me shkrim, në formë autobiografike, me adresën e saktë dhe dokumentet origjinale ose fotokopjet e noterizuara, si më poshtë:

- a) Ekstraktin e plotë historik, nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me objekt aktiviteti në fushën për të cilën kërkohet pajisja me licensë;
- b) Vërtetim nga prokuroria, që subjekti nuk është në procedim penal;
- c) Dëshmi penaliteti për administratorin e shoqërisë;
- ç) Përgjigjen me shkrim mbi besueshmërinë për administratorin e shoqërisë, lëshuar nga Policia e Shtetit;
- d) Licencën për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit për ambientet e prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve;
- dh) Lejen e ndërtimit, shoqëruar me planimetrinë e objekteve për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve dhe municioneve të tyre, ku të jenë të parashikuar repartet e prodhimit, magazinimit, laboratorit i analizave kimike e balistike, poligonet, si dhe çdo njësi tjetër e cila i nevojitet procesit të prodhimit çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve;

- e) Kontratën e punësimit me drejtuesin teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik, kimist ose specialist prodhimi me përvojë pune, të paktën, 3-vjeçare, në fushën e prodhimit të armëve;
- ë) Skemën teknologjike të prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit, të miratuar nga drejtuesi teknik dhe nga administratori i shoqërisë;
- f) Projektin e magazinave të lëndëve të para eksplozive, të miratuar nga Reparti i Inspektim- Shpëtim-Minierave, në përputhje me vendimin nr. 533, datë 8.7.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë";
- g) Aktin teknik dhe projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi për mjediset ku do të prodhohen, magazinohen, çaktivizohen dhe/ose riparohen armët, ku të jenë përcaktuar sistemet e shuarjes së zjarrit, si brenda, ashtu edhe jashtë këtyre ambienteve;
- gj) Planin e veprimit dhe dokumentacionin për kushtet e sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve dhe stafit, të miratuar nga drejtuesi teknik dhe administratori i shoqërisë;
- h) Kontratën për ruajtjen e ambienteve të prodhimit, magazinimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve, me një shoqëri të pajisur me licencë të ruajtjes së sigurisë fizike, në të cilën të jetë parashikuar një plan i detajuar i masave të sigurisë, ku të përfshihen vendrojat, rrethimi, kamerat e sigurisë, si dhe çdo masë tjetër e marrë për sigurinë e objektit;
- i) Dokumentacionin teknik mbi pajisjet testuese për provat balistike dhe për pajisjet laboratorike për provat kimike;
- j) Dokumentacionin teknik për llojin, tipin, specifikimet teknike e standardet e ndjekura për armët dhe municionet që do të prodhohen, çaktivizohen dhe/ose riparohen.
- k) Përpara zbardhjes së licencës subjekti aplikues duhet të paraqesë kontratën mbi sigurimin e përgjegjësisë publike të subjektit dhe sigurimin e jetës e të shëndetit të punonjësve nga aksidentet.

Dokumentacioni i përmendur më sipër duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente, brenda 3 (tre) muajve të fundit nga data e aplikimit të subjektit.

## NENI 8

### Liçensimi i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese

Ndërmarrjet shtetërore ekzistuese që kryejnë veprimtari prodhimi, çaktivizimi dhe/ose riparimi të armëve, për t'u pajisur me licencë për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve, paraqesin pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve kërkesën me shkrim, në formë autobiografike, me adresën e saktë dhe dokumentet origjinale ose kopje të njësuara me origjinalin, si më poshtë:

1. Vendimin/urdhrin e emërimit të drejtorit të ndërmarrjes shtetërore;
2. Licencën për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit për ambientet e prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve;

3. Planimetrinë e objekteve për prodhimin armëve dhe municioneve të tyre, ku të jenë të parashikuar repartet e prodhimit, magazinimit, laboratorit i analizave kimike dhe balistike, poligonet si dhe çdo njësi tjetër e cila i nevojitet procesit të prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit, të miratuar nga drejtori i ndërmarrjes;
4. Urdhrin e emërimit të drejtuesit teknik/kryeinxhinierit të ndërmarrjes;
5. Skemën teknologjike të prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit, të miratuar nga drejtuesi teknik dhe nga drejtori i ndërmarrjes;
6. Aktin teknik si dhe projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi për mjediset ku do të prodhohen, magazinohen, çaktivizohen dhe/ose riparohen armët, ku të jenë përcaktuar sistemet e shuarjes së zjarrit, si brenda, ashtu edhe jashtë këtyre ambienteve;
7. Planin e veprimit dhe dokumentacionin për kushtet e sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve dhe stafit, të miratuar nga drejtuesi teknik dhe drejtori i ndërmarrjes;
8. Dokumentacionin teknik mbi pajisjet testuese për provat balistike, si dhe pajisjet laboratorike për provat kimike;
9. Dokumentacionin teknik mbi llojin, tipin, specifikimet teknike dhe standardet e ndjekura për armët dhe municionet që do të prodhohen, çaktivizohen dhe/ose riparohen.

## NENI 9

### Ekspertët

Për shqyrtimin e dokumentacionit teknik, AKSHE kërkon nga institucionet shtetërore ose angazhon ekspertë të jashtëm të fushës të cilët do të shqyrtojnë dokumentacionin teknik të paraqitur në aplikim.

Thirrja e ekspertëve behet në varësi të problematikave, me kërkesë nga drejtoritë e AKSHE, dhe vendimi për angazhimin e tyre miratohet nga Kryetari i AKSHE-së. Ekspertiza e përgatitur me shkrim dorëzohet tek Kryetari i AKSHE-së brenda 10 ditësh pune nga data e caktimit të tyre. Ekspertët përgjigjen për pjesën teknike të aplikimit. Ekspertët mund të thërriten gjatë gjithë fazave të ndryshme të procesit të liçensimit në varësi të problematikave.

## NENI 10

### Detyrat e ekspertëve

Ekspertët shqyrtojnë dokumentacionin si më poshtë:

1. Lejen e ndërtimit, shoqëruar me planimetrinë e objekteve për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve dhe municioneve të tyre, ku të jenë të parashikuar repartet e prodhimit, magazinimit, laboratorit i analizave kimike e balistike, poligonet, si dhe çdo njësi/objekt tjetër e cila i nevojitet procesit të prodhimit;
  2. Skemën teknologjike të prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit, të miratuar nga drejtuesi teknik dhe nga administratori i shoqërisë;
  3. Verifikimin e mjedisit ku do të prodhohen, magazinohen, çaktivizohen dhe/ose riparohen armët, ku të jenë përcaktuar sistemet e shuarjes së zjarrit, si brenda, ashtu edhe jashtë këtyre ambienteve;
  4. Planin e veprimit dhe dokumentacionin për kushtet e sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve dhe stafit, të miratuar nga drejtuesi teknik dhe administratori i shoqërisë;
  5. Dokumentacionin teknik mbi pajisjet testuese për provat balistike dhe për pajisjet laboratorike për provat kimike;
  6. Dokumentacionin teknik për llojin, tipin, specifikimet teknike e standardet e ndjekura për armët dhe municionet që do të prodhohen, çaktivizohen dhe/ose riparohen.
- Në rastet e prodhimit dokumentacioni për llojet tipin e armëve duhet të shoqërohet edhe me patentat përkatëse për armën që do të prodhohet. Kjo patentë mund të jetë e regjistruar në Republikën e Shqipërisë ose e jashtë shtetit.

## NENI 11

### Marrja e vendimeve

Miratimi ose refuzimi për lëshimin e licencës së prodhimit të armëve për kategoritë "A", "B" dhe "C", të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 8, të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", bëhet me vendim të argumentuar të AKSHE-së, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit. Miratimi ose refuzimi për lëshimin e licencës për çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve të zjarrit për kategoritë "A", "B" dhe "C" bëhet me vendim të AKSHE-së, brenda 3 (tre) muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit.

AKSHE-ja pas marrjes së vendimit i kthen përgjigje zyrtarisht subjektit sipas afatit të parashikuar në Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Kryetari i AKSHE-së merr vendimin për miratimin, rinovim, refuzimi, pezullimin, dhe heqjen e licencës, brenda 5 ditëve nga paraqitja e raportit përfundimtar të Drejtorëve të Drejtorive në AKSHE.

Vendimi për miratimin, rinovim, refuzimi, pezullimin, ndryshimin dhe heqjen e licencës shoqërohet me relacion argumentues ku argumentohet vendimi i marrë i cili



përgatitet nga sektori i Legjislacionit dhe i Përfaqësimit dhe siglohet nga Drejtorët e Drejtorive.

## NENI 12

### Kontrolli, Inspektimi

Për subjektet që kërkojnë licensë prodhimi, çaktivizimi apo riparimi armësh, AKSHE-ja, vetëm apo së bashku me specialistë të fushës, sipas problematikave të lindura, ka të drejtë të ushtrorë kontroll në objektin e prodhimit, si dhe në dokumentacionin e tyre për këtë lloj aktiviteti sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë si në fazën e shqyrtimit të kërkesës për licensë prodhimi, si gjatë aplikimit për marrjen e licensës, gjatë procesit të licensimit, si dhe pas pajisjes me licensë.

Kontrolli dhe Inspektimi kryhet sipas dispozitave të Ligjit Nr.10 433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe dispozita të tjera të zbatueshme në fuqi.

## NENI 13

### Tarifat e licensimit

- Paguesa për tarifën e licencimit për prodhimin e armëve të zjarrit është 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
- Për licencën e prodhimit, për çdo tipologji artikulli që do të prodhohet, paguhet një tarifë shtesë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.
- Tarifa për licencimin për çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve të zjarrit është 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.
- Tarifa për rinovimin e licencave të prodhimit ose çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve, është e njëjtë me tarifën për aplikim fillestar për licencimin e këtyre aktiviteteve.
- Tarifa për licencimin, prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve të zjarrit derdhet në buxhetin e shtetit.
- Mandat pagesa e tarifës paraqitet nga subjekti aplikues pas marrjes së vendimit për miratimin e licensës, nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe para zbardhjes së licencës.

## NENI 14

### Bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore

AKSHE-ja bashkëpunon me institucionet të tjera shtetërore (Ministria e Punëve të

Brendshme, Ministria Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipërmarrjes Ministria Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Shërbimet e Inteligjencës dhe institucione të tjera shtetërore sipas problematikës) për zbatimin e legjislacionit në fuqi në lidhje me këtë rregullore.

Ajo shkëmben informacione në rrugë zyrtare për subjektet që licencohen si dhe kërkon informacion nga agjensitë ligjzbatuese mbi analizën e riskut të subjekteve/individëve dhe palëve të përfshira në aplikimin për liçensim.

## NENI 15

### Elementet Liçensave

2. Liçensa përmban këto elemente:

- numrin e protokollit dhe datën e lëshimit;
- emrin e subjektit të cilit i jepet (i plotë);
- numrin dhe datën e vendimit të Kryetarit për dhënien e liçensës
- mënyrën e përdorimit të liçensës, për prodhim/caktivizim riparim armësh;
- vendin ku do të kryhet veprimtaria
- afatin e vlefshmërisë;
- detyrimet që ka subjekti ndaj AKSHE-së;

3. Në formë tabele liçensa duhet të përmbajë:

- llojin e Armës me përshkrimin të detajuar,
- kategoria sipas klasifikimit të armës
- emrin tregtar të armës,

## NENI 16

### Ndalimi i transferimit të liçensës

1. Liçensa e prodhimit, çaktivizimit dhe/ose riparimit të armëve të zjarrit nuk lejohet të transferohet nga një person fizik a juridik te tjetri. Në rastet e ndryshimit të pronësisë subjekti blerës duhet të aplikojë për t'u liçensuar pranë AKSHE-së.
2. Kur një subjekt humbet liçensën njofton menjëherë zyrtarisht AKSHE-në dhe pajiset me dublikatë, me plotësimin e dokumenteve që konsiderohen të nevojshme nga AKSHE-ja.
3. Liçensa tërhiqet nga përfaqësuesi ligjor ose administratori i shoqërisë, ose nga një person i autorizuar nga administratori i shoqërisë për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit depozitohet në dosjen që arkivohet).

## NENI 17

### Mbajtja e të dhënave

Subjekti i pajisur me licencë për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve duhet:

1. të mbajë të dhënat në regjistra elektronikë dhe në letër, mbi sasinë e prodhuar, çaktivizuar dhe/ose riparuar për çdo armë dhe municion të përfunduar, si dhe për pjesët përbërëse të tyre;
2. të mbajë të dhënat në regjistra elektronikë dhe në letër për çdo copë, sasi të shitur brenda apo jashtë vendit;
3. të mbajë të dhëna për çdo model eksperimental para prodhimit;

Të dhënat e mësipërme duhet të mbahen nga subjekti për një afat minimal 10-vjeçar

## NENI 18

### Raportimi i subjekteve

Subjekti i pajisur me licencë për prodhimin, çaktivizimin dhe/ose riparimin e armëve duhet: të raportojë, çdo muaj, pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, për sasinë e prodhuar/çaktivizuar ose riparuar, llojin, tipin, numrin e serisë.

Të dhënat e mësipërme duhet të mbahen nga subjekti për një afat minimal 10 - vjeçar

## NENI 19

### Sanksionet

Në rast kur gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, vëren shkelje të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Vendimin Nr. 658, datë 29.7.2015 "Për përcaktimin e procedurave për dhënie e licencave për prodhimin, çaktivizimin dhe riparimin e armëve" të Këshillit të Ministrave do të aplikohen sanksionet e parashikuara në Kreun III, pika 1 dhe 2 e këtij vendimi.

## NENI 20

### Ankimi ndaj vendimeve të AKSHE-së

Vendimet e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve mund të ankimohen tek ministri i Mbrojtjes, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni.

2. Ministri i Mbrojtjes, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së ankimit, vendos për lënien në fuqi, ndryshimin ose shfuqizimin e vendimit të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

3. Ndaj vendimit të ministrit të Mbrojtjes mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni.

## **NENI 21**

### **Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit**

Dosjet e aplikimit si dhe dokumentacioni i depozituar në Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, ruhet në arkivën e këtij institucioni sipas të gjitha rregullave të përcaktuara në Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

## **NENI 22**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.